

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Uran Ismaili – Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	23.05.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Haxhi Avdyli – Deputet i Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Mungesa e barnave.

Pyetja parlamentare: Ka raportime nga institucionet shëndetësore dhe pacientet që gjendja e furnizimit me barna është keqësuar. Ka mungesa të barnave me bazike për trajtim e për operacione, ka mungesa të barnave për trajtim onkologjik e insulinave . Duke e marrë parasysh që ju si ministër ka kohe që keni lajmëruar revidimin e listës esenciale ,pastaj keni paralajmëruar ndryshimin e politikave të prokurimit , dhe furnizim me të qëndrueshëm me barna nga lista esenciale etj.pse akoma vazhdojnë mungesat e tilla. Deri ku keni arritur në përmirësimin e këtyre politikave të lartcekura për furnizim me të mirë me barnave.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	Propozim për Parlamentarë Kandidate nga të Prdiogët e Prëditëve të Tabllës Oficiale
Prat. E. Prat. Prot. No.	06/1424/Do-804
Nr. i lexëve Shprehjet e Mendimit No pages	01.06.2018
PRISHTINË - PRISTINA - FRISTINA	

PËR / ZA / TU	Uran Ismajli, Ministër i Shëndetësisë	DATE DATU	01 qershor 2018
NGA / OD	Time Kadrijaj, Deputete, Grupi Parlamentar i AAK-së		
FROM SUBJECT SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Shpesh herë nëpër mediat tona është përfol qështja e stendave. Shumë pacient që janë trajtuar nëpër klinikat private për këtë qështje kanë paguar shuma të larta për këtë intervenim dhe ka ndodhë që kur këta pacient kanë kryer vizita qoftë brenda apo jashtë vendit ka rezultuar se nuk e kanë numrin e stendave për të cilat kanë paguar, (nese ju është thënë që i kanë dy stenda apo tri stenda, ka rezultuar që kanë në apo dy stenda). Sipas kësaj kjo qështje është komercializuar skajshmërisht dhe mendoj që është shumë shqetësuese.

Pyetja: Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë, për të saktësuar apo për të demantuar këto ngjarje?



REPUBLIC OF KOSOVO
 KUVENDI I REPUBLICES SË KOSOVES
 SKUPŠTINA REPUBLICË KOSOVA
 ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO

Titulli i Propozimit dhe Përmbajtja: Komisioni për Përditimin e Tabela Offici...

Nr. Prot. 06/1425/No. 805
 Nr. Prot. 01.06.2018
 Pristina - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Uran Ismajli, Ministër i Shëndetësisë	DATE DATU M RDATE	01 qershor 2018
NGA / OD	Time Kadrijaj, Deputete, Grupi Parlamentar i AAK-së		
FROM SUBJECT PREMI T SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: Shumë pacient për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike kërkojnë ndihmë dhe përkrahje materiale nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria ato raste që i plotësojnë kushtet i përkrah me 70% të shumës së kërkuar duke u bazuar në profaturat e sjella nga institucionet ku ata do të trajtohen, paratë që merren nga Ministria e Shëndetësisë shkojnë direkt në institucionet shëndetësore. Problemi është se pacientët edhe pse i dërgojnë konfirmimin nga Ministria e Shëndetësisë detyrohen të paguajnë të tërë shumën deri sa ju alokohen mjetet nga ministria e shëndetësisë, pacientët më pas po kanë probleme në tërheqjen e këtyre parave nga institucionet e caktuara.

Pyetja: Pse nuk bëhet një dakordancë që pacientët të paguajnë veq shumën e parave që nuk e paguan ministria e shëndetësisë, sepse pacientët po malltreshen me ditë dhe javë për të kthyer paratë?



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕСПУБЛИКА КОСОВО KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Tema për Propozim dhe Parachitje - Konularje za Fudbalo i Predstavke Tabela Ofi.	
№ Propozim № Parachitje Prot. No:	06/1426/Do-806
№ Figura № Parachitje № Pjesë	Data Publikim Date: 01.06.2018
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Shëndetësisë – Uran Ismaili</i>	DATE DATU M DATE	24 Maj 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Imet Rrahmani, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së</i>		
SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Nevojat e SHSKUK -së dhe institucioneve tjera për aparaturë janë të mëdha përkundër investimeve në të kaluarën. Një investim i tillë prej 1.6 milion euro ka ndodhur në vitin 2016 përmes Projektit me Bankën Botërore për përmirësimin e kushteve të punës në Klinikën dhe Repartet e Pediatrisë dhe Neonatologjisë në SHSKUK në nivel terciar dhe sekondar. Në fillim të vitit 2017 patëm avancuar në krijimin e listës së nevojave me prioritet për aparaturë sidomos në radiologji në të dy nivelet.

Pyetja:

I nderuar Ministër, a i keni këto informata dhe ku ka mbërri procesi i blerjes së asaj aparature.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/1434/10-809
04.06.2018

PËR / ZA / TO	Z. Pal Lekaj, Ministër i Infrastrukturës.	DATE DATUM DATE	04 qershor 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Teuta Haxhiu, Deputete, Grupi Parlamentar i AAK-së		
SUBJEKTI PREDMET T SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Qështja: Në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, është ndarë një shumë prej 150.000 Euro, për asfaltimin e rrugës Smolicë- Nivokaz, shumë e cila edhe pse nuk është e mjaftueshme për tu përfunduar projekti por kërkesa e qytetarëve është e vazhdueshme që të shohin fillimin e punimeve në atë rrugë.

Pyetja: Kur do të nis ndërtimi i kësaj rruge?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/1435/90-810
04.06.2018

PËR / ZA / TO	Z. Uran Ismajli, Ministër i Shëndetësisë.	DATE DATUM DATE	04 qershor 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Teuta Haxhiu, Deputete, Grupi Parlamentar i AAK-së		
SUBJEKTI FREDME T SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Qështja: Aktualisht rezonanca magnetike e vetmja në Qendrën Klinike Universitare në Kosovë është jashtë funksionit, lista e pritjes së pacientëve për një rezonancë magnetike është 2500 pacient.

Pyetja: Kur do të funksionalizohet puna e rezonancës magnetike në Qendrën Klinike Universitare në Kosovë dhe a keni menduar që të investoni edhe në një rezonancë magnetike në Spitalet Regjionale në Kosovë?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës Assembleja e Kosovës ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Drita për Propozime dhe Përshkrime - Këshillat dhe Propozimet e Propozuesve të Drita	
Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No:	06/1462/D-823
Nr.faqeve Broj. strana No. pages:	Dato Datum Date: 06.06.2018
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj, Ministër i Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 është përfshirë projekti për Mitrovicën Veriore lidhur me rrugën "Sami Frashëri" në gjatësi prej 300 m.

Emri i projektit i përfshirë në buxhet është "Asfaltimi i rrugës Sami Frashëri, ne gjatësi prej 300 metra, ne Mitrovicën Veriore" (kodi i projektit 15762).

Kjo është e vetmja rrugë e banuar nga shqiptarët në atë pjesë të Mitrovicës dhe nuk është e asfaltuar. Shuma që kërkohet nuk është e madhe, ndërkohë që përfaqësuesit e kësaj lagje kanë shprehur vullnetin që të ndihmojnë në realizimin e këtij projekti, në rast të ndonjë çështjeje pronësore apo adaptim të projektit për të bërë rrugën më të përshtatshme.

PYETJA: Në çfarë faze është projekti tani? A keni kontaktuar me përfaqësuesit e lagjes?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

ASSEMBLY OF KOSOVO
Kuvendi i Kosovës
No. of the Document: 06/1481/D-833
Date: 07.06.2018

PËR / ZA / TO	z. Bejtush Gashi Minister i Punëve të Brendshme.	DATE DATU M DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Bilall Sherifi, Deputet - Nisma Socialdemokrate		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës

Çështja: I nderuar z. Minister, duke pasur parasysh faktin që në Kosovë viteve të fundit kanë ndodhur shumë aksidente në komunikacion, deshiroj të di sa aksidente kanë ndodhur gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017 në Republikën e Kosovës? Sa nga këto aksidente kanë përfunduar me lëndime të rënda dhe sa me të lehta, po ashtu sa njerëz kanë humbur jetën në këto aksidente gjatë këtyre tri viteve?

Pyetja: Sa përqind të veturave të cilat kanë qenë të përfshira në aksidentet e kësaj periudhe kanë qenë të përgjistruara ose me afat të skaduar të regjistrimit?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI - REPUBLIKES SE KOSOVES SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime të Propozimeve - Konsilium za Predložene Predstavke Table Office	
No. Prop. Br. Prop. Prot. No.	06/1500/10-844
No. Prop. Br. Prop. Prot. No.	
No. Prop. Br. Prop. Prot. No.	
Date Datum Date	
12.06.2018	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

PËR / ZA / TO	Pal Lekaj Ministër i Infastrukturës	DATE DATUM DATE	12.06. 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Besa Baftiu, deputete GP të Partisë Socialdemokrate <i>Baftiu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Z. Ministër,

Komuna e Gjilanit është një ndër komunat me infrastrukturë rrugore më të dobët në Kosovë. Natyrisht që ndërtimi i autostradës Gjilan-Prishtinë është një lajm i mirë për qytetaret e kësaj ane sepse do të krijohet një lidhje me e shpejtë dhe e sigurt me Kryeqytetin Prishtinën. Por Gjilani ka një lidhje shumë të ngushtë bashkëpunimi ekonomik edhe me komunën e Ferizajit dhe Vitisë, magjistralja që e lidhë Gjilanin dhe Ferizajin është shumë e dëmtuar, nuk mirëmbahet kështu që po vështerson qarkullimin e automjetve dhe po rrezikon edhe jetën e qytetarve.

Pyetja Parlamentare

Minister a keni plane për ta rregulluar apo zgjeruar këtë magjistrale në mënyrë që të ju mundësohet qarkullim më i lehtë dhe i shpejtë qytetarëve të Gjilanit në drejtim te Ferizajit, Vitisë si dhe fshatrave që shtrihen përreth magjistrales?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/1505/Do-849
12.06.2018

PËR/ZA/TO	z. Mahir <u>Yağcılar</u> - Ministër i Administratës Publike	DATE DATUM DATE	12.06.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Salih Zyba – deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		<i>Sh</i>
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Pagesa e qirasë për hapësirat dhe objektet në lokacionin ku është e vendosur Agjencioni Kundër Korrupsionit.

PYETJA

I nderuar z. Ministër,

A jeni në dijeni për pagesat e qirasë për objekte dhe hapësira të ndryshme që gjenden në lokacionin ku është e vendosur Agjencioni Kundër Korrupsionit?

A mund të na njoftoni për bazën ligjore të pagesës së hapësirës së lirë pranë lokacionit ku është vendosur selia e AKK, e cila përdoret si vendparkim i lirë për automjete private, pas ndërprerjes disavjeçare?

A mund të na njoftoni për mënyrën e caktimit të pagesës për ndërtesën e vendosur brenda lokacionit ku është vendosur ndërtesa e AKK por nuk shfrytëzohet nga AKK, pas ndërprerjes disavjeçare?

A mund të na informoni për arsyet e ndërprerjes së pagesës në emër të qirasë për këto hapësirë gjegjësisht ndërtesë, dhe tani disa vite më vonë vendimin për rifillimin e pagesës për të njëjtat? Cilat janë ndryshimet ligjore, pronësore apo gjyqësore që kanë ndikuar për rifillimin e kësaj pagese pas ndërprerjes disavjeçare? Cila është baza ligjore për këto pagesa?



REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVA
ASSEMBLY
Prishtinë - Prishtina - Pristina
12.06.2018
06/1507/10-851

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	z. Pal Lekaj – Ministër i Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	12.06.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Sami Kurteshi - deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Çështja e hapjes së vendkalimit kufitar ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, në aksin rrugor Gjilan-Kumanovë, në pikën kufitare Stanaj-Bellanoc.

PYETJA

I nderuar Ministër,


Pas problemeve dhe ndërprerjes së aksit rrugor midis Prishtinës dhe Shkupit, gjegjësisht Kaqanikut dhe Hanit të Elezit diku rreth një muaj, sërish dolën në pah problemet e kalimit nga Kosova në Maqedoni. Rruga alternative Prishtinë-Glloboqicë-Hani i Elezit, përveç vështirësive fizike, është shumë (natyrisht jo për banorët e atyshëm) më e gjatë dhe më e mundimshme dhe për rrafsh një orë më e gjatë sesa rruga normale (magjistranja) Prishtinë-Kaqanik-Hani i Elezit.

Midis Gjilanit dhe Kumanovës, nëpër grykën e Karadakut të Gjilanit, tanimë ekziston infrastruktura rrugore solide, madje shumë e mirë në pjesën maqedonase, sepse është ndërtuar para disa muajsh. Kjo rrugë që tani është përshtatshme për automjete të vogla dhe mesme, deri në 3-5 tonelata, përveç disa përmirësimeve të pakta që sigurisht duhet dhe mund të bëhen me shumë pak mjete dhe brenda një periudhe të shkurtë kohore, lehtësisht mund të përshtatet edhe për automjete gjysmë të rënda, deri në 10-15 tonelata.

Largësia midis Gjilanit dhe Kumanovës, si dy qendra kryesore të rajonit, është më e shkurtër se 40 kilometra. Ndërtimi i një vendkalimi kufitar zyrtar me Republikën e Maqedonisë në vendkalimin tani të përdorur nga banorët lokal të zonës në Stanaj (Stanqiq) – Bellanoc do të lehtësonte dukshëm komunikimin dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, me kursime jashtëzakonisht të mëdha të kohës dhe mjeteve për së paku 200-300'000 banorë të të dy komunave; do të ndihmonte sado-kudo zhvillimin ekonomik të zonës në fjalë, sidomos turizmin; dhe njëkohësisht do të ndalonte dukshëm, shpopullimin e zonës.

Pyetja: A planifikon Qeveria e Kosovës hapjen e vendkalimit kufitar Stanaj-Bellanoc, natyrisht në bashkëpunim me qeverinë maqedonase? Nëse jo, cilat janë problemet dhe pengesat objektive apo subjektive? Nëse po, kur planifikohet një veprim i tillë? Përfundimisht, nëse po, kur mund të shpresojnë banorët e zonës se mund të kalojnë këtë vendkalim kufitar në mënyrë zyrtare?

Falemnderit për bashkëpunimin!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj - Ministër i Infrastrukturës	DATE DATU M DATE	12. 06. 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Valon Ramadani, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJE KTI FREDM ET SUBJE CT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


ÇËSHTJA

Gjendja e rëndë e rrugës që lidh fshatrat Tërrn dhe Bablak me magjistralen Ferizaj –Prishtinë

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar Ministër

A jeni i informuar për gjendjen e rëndë të rrugës që lidhë fshatrat Tërrn dhe Bablak me magjistralen Ferizaj -Prishtinë e cila është në gjendje katastrofale dhe nëse po a keni planifikuar të merrni masa dhe kur do ta bëni një gjë të tillë?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj - Ministër i Infrastrukturës	DATE DATU M DATE	12.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Valon Ramadani, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


ÇËSHTJA

Deshiroj të sqaroni çështjen e rrugës ndërkomunale mes fshatit Komogllave të Ferizajt dhe fshatit Trestenik të Vitise e cila është nisur para 1 viti gjatë fushatës për zgjedhjet qendrore dhe punimet janë ndërprerë menjëherë pas zgjedhjeve.

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar Ministër,

Banorët e fshatit Komogllave janë të interesuar të dijne nëse punimet do të fillojnë dhe kur do të fillojnë?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PER/ZA/TO	Kryeministrin e Kosovës z. Ramush Haradinaj	DATE DATUM DATE	12.06.2018.
NGA/OD/FROM	Deputeti: Bekim Haxhiu	B. HAXHIU	
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja :

I nderuar kryeministër Ramush Haradinaj,

Me datë 10.05.2018. protokolluar me 11.05.2018. me Nr. 463-579, Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal ju ka dërguar kryetarëve të Komunave të Kosovës një njoftim: "Lidhur me kërkesën për pezullimin e shqyrtimit të kërkesave për kthimin e pronave të cilat menaxhohen nga AKP në pronësi të komunave".

Në këtë njoftim të cilin do të i bashkangjës kësaj pyetje parlamentare thuhet: " Murrë parasysh që MAPL është në fazën finale të miratimit të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, në bashkpunim të plotë me Zyrën e Kryeministrit , ju njofton se procesi i shqyrtimit të kërkesave për kthimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore të cilat menaxhohen nga AKP në pronësi të komunave do të pezullohet deri në miratimin e ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, i cili projekt ligj përcakton detalisht realizimin e këtij procesi".

I nderuar Kryeministër ju keni deklaruar se do të ndaloni shitjen nga AKP të pronave tokave në komuna, ndërsa ky vendim është në kundërshtim të plotë me qendrimet e juaja. Gjithashtu është shumë shqetësuese shfuqizimi i Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtëshme të Komunës, me vendim të sekretarës së përgjithëshme të MAPL zj. Rozafa Ukimeraj.

I nderuar Kryeministër , shfuqizimi i ligjeve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës nuk mund të bëhet nga sekretarët e përgjithëshëm të ministrive , por sekretarët janë të obliguar të zbatojnë ligjet e miratuar nga Kuvendi i Kosovës deri sa ato nuk ndryshohen nga Kuvendi i Kosovës.


Me blloku investimet në komunat e Kosovës dhe me prillonguar ato vetëm pse MAPL është në fazën finale të draftimit, jo miratimit sepse ministria nuk miraton ligje, është vendim i pa menduar mirë dhe i pa arsyeshëm.

PYETJE

I nderuar Kryeministër, pasi që ky vendim është në kundërshtim me deklaratimet e juaja për shitjen e tokave nga AKP, pronat shoqërore , tokat në komunat e Kosovës, a ju ka konsultuar MAPL për këtë njoftim i cili i'u është dërguar kryetarëve të Komunave? Ngase sipas këtij vendimi AKP mund të vazhdojë të shes tokat të Komunave dhe kjo do të vështërsojë investimet në Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PER/ZA/TO	Ministrinë e Shëndetësisë z.Uran Ismailin	DATE DATUM DATE	12.06.2018.
NGA/OD/FROM	Deputeti: Bekim Haxhiu B. HAXHIU		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja :

I nderuar ministër Ismaili, siç e dini Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar marrveshjen e kredisë me Unicredit Bank Austria AG për "Projektin modernizimi i shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK". Ky projekt që nga fillimi është përcjellur me parregullësi nga ana e MSH, prandaj unë kam ngritur në vazhdimësi shqetësimet e mia për këtë projekt, për rritjen e shumës së kredisë nga 2.1 milion Euro në 2.6 milion Euro dhe çështje të tjera tani më të njohura, për këtë fakt kjo marrveshje ka pas vështëris të ratifikimit në Kuvendin e Kosovës.

Për këtë çështje kam paraqitur shqetësimin tim në Kuvendin e Kosovës, në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si dhe ju kam parashtruar pyetje parlamentare .

Edhe pse Kuvendi i Kosovës me shumë vështërsi ka ratifikuar këtë marrveshje në vitin 2016, apratuarat e kontraktuara për "Projektin modernizimi i shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK" ende nuk kanë arritur në Kosovë.

Ndërsa ju i nderuar ministër në përgjigjen që keni dhënë në Kuvendin e Kosovës me datë 08.02.2018. keni deklaruar se:

'Çështja do të mbyllet shpresoj për tre muaj, jam i bindur që do të mbyllet në tre muajt e ardhëshëm dhe do të kemi një apartaurë, pas një zhagitje dy vjeqare...'

Pyetjen po e parashtroj me datë 08.06.2018, do të thotë 4 muaj pasi që ju keni deklaruar se çështja do të mbyllet për 3 muaj.

Prandaj ju parashtroj këtë pyetje parlamentare:

PYETJE :

I nderuar ministër,

A mundeni me dhënë sqarim shtesë pse nuk keni realizuar fjalën e dhënë në Kuvendin e Kosovës, pse aparatuara e blerë përmes kredisë për "Projektin e modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK" nuk është ende në shërbim të pacientëve?



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Prodhim: Kuvendi i Kosovës - Kancelaria e Prindjeve i Prisedevka - Table Office

No. i fletës: 06/1551/P-880
No. i listës: 19.06.2018
No. i pagës: PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Shyqiri Bytyqi - Ministër i Arsimit	DATE DATUM DATE	19.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE! / Kurteshi		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Shkollimi i të miturve në qendrat e paraburgimit


Në qendrën korrektuese në Lipjan, gjendet një numër i konsiderueshëm i të miturve që e vuajnë dënimin, bazuar në ligj, MASHT-i është i obliguar t'ju siguroj atyre vijimin e shkollimit brenda qendrës korrektuese.

Po ashtu shteti ka obligim të ndikoj edhe në risocializimin dhe aftësimin profesional të të rriturve që gjenden në burgjet e Kosovës.

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar Ministër,

Çka po ndërmerr MASHT-i në shkollimin dhe aftësimin profesional të kategorive të lartpërmendura?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA /TO	z. Shyqiri Bytyqi - Ministër i Arsimit	DATE DATUM DATE	19.06.2018
NGA / OD /FROM	Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE!	Reference	I. Kurteshi
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHITJA: Provimi i Maturës

Edhe këtë vit testet e maturës u publikuan në ditën e testit për kundër masave të proklamuar.

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar Ministër,

Çka ka ndërmarr ministria me i zbuluar publikuesit e testit? Çka do të ndërmerr ndaj të gjithë atyre që kanë kontribuar në publikimin e testit? Çka do të ndërmerrni që gjëra të tilla të mos përsëriten në të ardhmen? Z. Ministër, a ndiheni edhe personalisht fajtor për këtë skandal?